



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202001622/5

Tiranë ___/___/2020

Lënda: *Rekomandohet përmbushja e detyrimit ligjor për, dhënien e informacionit në dokumenta publike në favor të kërkuarit F.J..*

Përgatitjen në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënien në dispozicion të publikut në faqen zyrtare në internet të Bashkisë Këlcyrë/Autoriteti Publik të kategorisë së informacionit të parashikuar në nenin 7 të ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e informimit", lidhur me projektin "Rijetizimi i pedonaleve dhe krijimi i hapsirave rekreative në sheshin qendër", Këlcyrë.

Drejtuar : **Bashkia**

KËLCYRË

Për dijeni: **F.J.**

Adresa: janifredi66@gmail.com

I nderuar z.Kryetar!

Institucioni i Avokatit të Popullit, në procesin e shqyrtimit të ankesës së paraqitur prej shtetasit F.J., ka konstatuar, se, çështja për të cilën ky shtetas ka kërkuar ndërhyrjen e Institucionit tonë lidhet me shkeljen e së drejtës të informimit nga ana e Bashkisë Këlcyrë.

Për këtë çështje, referuar informacionit të dhënë prej ankuesit si dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale, rezulton, se:

Me kërkesën datë 02.10.2019, depozituar në adresën elektronike info@bashkiakelcyre.gov.al, z.F.J., ka kërkuar Bashkisë Këlcyrë, vënien në dispozicionin të informacionit/dokumentacionit në lidhje me projektin "Rijetizimi i pedonaleve dhe krijimi i hapësirave rekreative në sheshin qendër", Këlcyrë, si:

1. *Kush është autoriteti për ndërmarrjen dhe hartimin e nismës së projektit "Rijetizimi i pedonaleve dhe krijimi i hapsirave rekreative në sheshin qendër", Këlcyrë,*
2. " (autori-etj).

Pa shkak, Bashkia Këlcyrë, nuk ka përmbushur detyrimin ligjor ndaj z.Jani, për dhënien e informacionit sikurse parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku sanksionohet:

“1.Edrejta e informimit është e garantuar.

2.Kushdo ka të drejtë në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore....”

dhe në ligjin 119/2014, *“Për të drejtën e informimit”*, neni 3, ku thuhet:

“E drejta e informimit

- 1. Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.*
- 2. Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar.*
- 3. Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.*
- 4. Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji”.*

Me pretendimin se i është cënuar e drejta për informim, ankuesi, ka paraqitur ankimin nr.1696/1 Prot, datë 01.11.2019, dhe datë 06.11.2019, pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili në përfundim të shqyrtimit të kësaj çështjeje ka vlerësuar, se, argumentat e parashtruara nga Bashkia Këlcyrë, nuk qëndrojnë si dhe urdhërimin e saj me anë të aktit administrativ nr.32, datë 12.11.2019, për vënien në dispozicion të z. Jani të informacionit/dokumentacionit të kërkuar prej tij. Ndaj këtij vendimi, Bashkia Këlcyrë, nuk ka ushtruar ankim brenda afatit ligjor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër. Për rrjedhojë, vendimi i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është i ekzekutueshëm dhe pasjell vendosjen e penaliteteve sikurse parashikuar në nenin 18/2/a. të ligjit nr.119/2014, *“Për të drejtën e informimit”*:

“Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet

- 1. Mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji passjell përgjegjësi administrative, sipas rasteve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni.*
- 2. Veprimet dhe mosveprimet, në përputhje me këtë ligj dhe për aq sa nuk përbëjnë vepër penale, konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:
a) refuzimi i dhënies së informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë; ...”*

Konstatohet, se, informacioni i kërkuar prej shtetasit F.J., bën pjesë sipas parashikimit të kryer në nenin 7 të ligjit nr.119/2014, *“Për të drejtën e informimit”*, në kategorinë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë, në përputhje me programin e transparencës të miratuar për çdo autoritet publik. Sipas parashikimit të kryer në këtë dispozitë urdhëruese të ligjit, Bashkia Këlcyrë, ka detyrimin e vënies në dispozicion të publikut në faqen e saj në internet të kategorisë së informacionit të kërkuar prej z.F.J..

Qënrimit i Bashkise Këlcyrë, në përmbushjen e detyrimit të parashikuar në nenin 7 të ligjit nr.119/2014, *“Për të drejtën e informimit”*, nuk vjen në përputhje me parimin e transparencës sikurse parashikuar në nenin 5 të ligjit nr.44/2015, *“Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”*, se:

“Organet publike ushtrojnë veprimtarinë administrative në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në të”

Gjithashtu, procedura e kryer prej Bashkise Këlcyrë, në shqyrtimin e kërkesës së shtetasit F.J., nuk rezulton të jetë në përputhje me parashikimin e nenit 6 të ligjit nr.44/2015, *“Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”*, ku thuhet, se:

“Parimi i informimit

- 1. Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion publik, që ka të bëjë me veprimtarinë e organit publik, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon të drejtën e informimit.*
- 2. Në rastet kur informacioni i kërkuar refuzohet, organi publik merr vendim të arsyetuar me shkrim, i cili përmban edhe udhëzimet për ushtrimin e së drejtës për ankim dhe i njoftohet menjëherë palëve në proces”.*

Bashkia Këlcyrë, me rastin e refuzimit të kërkesës së z.J., pa shkak, nuk ka nxjerrë vendimin e arsyetuar me shkrim, sikurse parashikuar në dispozitën ligjore të sipërcituar.

E drejta e informimit për dokumentet zyrtare është një e drejtë e individit e cila lidhet drejtpërdrejt me të drejtën për një proces të rregullt ligjor gjatë zhvillimit të procedurave administrative. Për këtë arsye ajo është një e drejtë e mbrojtur dhe garantuar nga aktet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (neni 19), Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (neni 10). Këshilli i Evropës ka miratuar një sërë rekomandimesh për të drejtën e informimit, të cilat janë tregues i kuptimit që ka ky organizëm mbi këtë çështje, dhe që shërbejnë si udhërrëfyes për vendet anëtare për rregullimin e kësaj të drejte. Po kështu, nisur nga rëndësia parësore që e drejta informimit ka për zhvillimin e demokracisë së një vendi, Këshilli i Evropës ka miratuar një Konventë të posaçme *“Për aksesin në dokumentet zyrtare”*.

E drejta e informimit është sanksionuar edhe në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Shqipërisë, pasqyruar në Kushtetutën e RSH (neni 23) dhe në ligjin nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*.

Ligji nr. 119/2014, rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike dhe ka për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike (neni 1 i ligjit).

Referuar qëndrimit të mbajtur prej Bashkisë Këlcyrë/Autoritetit Publik për këtë çështje, në analizë të legjislacionit procedural në fuqi, të legjislacionit që rregullon organizimin dhe funksionimin e këtij institucioni, të legjislacionit të brendshëm dhe ndërkombëtar që rregullon të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare, dhe të Kodit të Procedurave Administrative të RSH, institucioni i Avokatit të Popullit konstaton dhe vlerëson sa më poshtë vijon.

Qëndrimi i mbajtur nga Bashkisë Këlcyrë/Autoritetit Publik, ndaj së drejtës së informimit për ankuesin në fjalë, përbën mosrespektim të të drejtës për informim me anë të mosveprimit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit. Në qëndrimin e mbajtur nuk parashtrihen shpjegime apo argumenta të cilat të trajtojnë çështjen e kufizimit të të drejtës për informim sikundër shpjeguar më sipër në hyrje të këtij rekomandimi. Po kështu, mosrespektimi i programit të transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, për vënien në dispozicion të publikut në faqen e Bashkisë Këlcyrë, në internet, të kategorisë së informacionit të parashikuar në nenin 7 të ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit”, është shkelje e parimit të transparencës sikurse parashikuar në nenin 5 të ligjit nr. ligjit nr.44/2015, “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Për të gjitha sa më lart, bazuar Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 63/3, në të cilin thuhet se : “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar, neni 21/b në të cilin thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”,

REKOMANDON

Përmbushjen e detyrimit ligjor për dhënien e informacionit në dokumenta publike në favor të kërkuarit F.J..

Përgatitjen në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënien në dispozicion të publikut në faqen zyrtare në internet të Bashkisë Këlcyrë/Autoriteti Publik të kategorisë së informacionit të parashikuar në nenin 7 të ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit”, lidhur me projektin “Rijetizimi i pedonaleve dhe krijimi i hapësirave rekreative në sheshin qendër”, Këlcyrë.

Në përputhje me parashikimin e nenit 22, të ligjit nr.8454, datë 4.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, kthimi i përgjigjes të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj,

KOMISIONERI

Prof.Asoc.Dr. Erjona BANA(CANAJ)